



Kosovo Property Claims Commission
Omission i Kërkesave Pronësorete Kosovës
Komisija Kosovske Agencijeza Imovinu

Perandori Justinian 5
Pristina
Tel: +381 (0) 38 249-918
Fax: +381 (0) 38 249-919
E-mail: mailbox@kpaonline.org

VENDIM

PANELI NR: 1

NR I VENDIMIT: KPCC/D/C/169/2012
DATA E VENDIMIT: 05/09/2012

Komisionerët Heiskanen (Kryetar),
Vokshi dhe Wühler

URDHËR

(1) Në kërkesën nr. 53023 të referuar në pjesën A të listës së bashkangjitur, Komisioni

vendos që

Prej datës së shkatërrimit të pronës komerciale bartësi i së drejtës pronësore, ka përmbushur kërkesat për vërtetimin e pronësisë për pronën e kërkuar dhe ngastrën e bashkuar asaj, apo për pjesën e tillë si është specifikuar në vendimin përkatës individual;

(2) Në kërkesën nr. 53023 të referuar në paragrafin (1) më sipër, Komisioni

urdhëron që

(a) Mbajtësit të së drejtës pronësore t'i jepet posedimi i tokës së bashkuar mbi të cilën qëndronte prona komerciale;

(b) Çdo person tjetër i cili e ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme, ta lirojë atë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimi të këtij urdhri; dhe

(c) Nëse çdo person tjetër i cili e ka uzurpuar pronën në mënyrë të paligjshme dështon të përmbushë urdhrin për lirim të pronës brenda kohës së dhënë, ata të dëbohen nga prona.

(3) Në secilën prej pesë (5) kërkesave të identifikuara në pjesën (B) të listës së bashkangjitur, Komisioni vendos që kërkesa të hidhet poshtë; dhe

(4) Më tej, Komisioni vendos që kërkesat nr. 11541 dhe 14282 të hidhen poshtë për aq sa paraqitësit e kërkesave kërkojnë kompensim për dëmin material apo për humbjen e shfrytëzimit, të pronës së kërkuar.

KORNIZA LIGJORE

1. Më 13 qershor 2008, në Kosovë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 03/L-079 duke plotësuar dhe ndryshuar Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave që kanë të bëjnë me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Ligji përmban një aneks ("Aneksi I") i cili plotëson dhe ndryshon Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5, e cila zbaton Rregulloren e UNMIK-ut 2006/50. Me Ligjin nr. 03/L-079 dhe Aneksin i themelohet Agjencia Kosovare e Pronës ("AKP") si agjenci e pavarur, dhe ndryshohen dispozitat përkatëse të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 si të domosdoshme për të zbatuar ndryshimet në kornizën e aplikueshme ligjore. Në pajtueshmëri me dispozitat e tyre, Ligji nr. 03/L-079 dhe Aneksi i kanë hyrë në fuqi me publikimin e tyre në Gazetën Zyrtare.

2. Sipas nenit 22 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, Rregullorja pushoi së aplikuari me datën 31 dhjetor 2008. Prandaj, Ligji nr. 03/L-079 është aktualisht burimi i vetëm i autoritetit ligjor të Komisionit. Dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 vazhdojnë të mbesin relevante vetëm ashtu siç janë inkorporuar sipas Ligjit nr. 03/L-079.

ARSYET PËR VENDIM

3. Paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, ka të drejtë në urdhër nga Komisioni për riposedit të pronës, nëse paraqitësi i kërkesës dëshmon:

- (a) pronësinë mbi pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale; ose
- (b) të drejtën e shfrytëzimit në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale,

ku paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, tani nuk mund të ushtrojë të drejta të tilla pronësore, dhe ku kërkesa përfshin rrethanat e ndërlydhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)

4. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për pronësi në bazë të nenit 3.1(a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni duhet ta zgjidhë çështjen e pronësisë dhe, nëse Komisionit i është dëshmuar pronësia dhe paraqitësi i kërkesës nuk e dëshmon të kundërtën, të jap urdhër për riposedit në dobi të paraqitësit të kërkesës apo bartësit të së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti. Kur paraqitësi i kërkesës paraqet kërkesë për të drejtën e shfrytëzimit të pronës në pajtim me nenin 3.1(b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Komisioni mund të shqyrtojë kërkesën me procedurë përmbledhëse dhe të lëshojë urdhër për kthimin e posedimit. (Shih nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, lexo bashkë me nenin 9 të Aneksit III të Urdhëresës Administrative nr. 2007/5 të plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-079.)¹

¹ Duket se ka një gabim teknik në Aneksin I. Ndonëse në mënyrë të qartë paraqitet që Aneksi i kishte për qëllim të zëvendësonte në tërësi Urdhëresën Administrative të UNMIK-ut 2007/5, përfshirë që të tri Anekset e saj, Neni 26 i Aneksit i parasheh që e drejta nga Aneksi III i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 duhet të zëvendësohet me të drejtën e cila referohet në Aneksin II. Megjithatë, nuk ka ndonjë dispozitë të veçantë apo ndonjë të dhënë tjetër në Ligjin 03/L-079 apo në Anekset e tij që qëllimi i këtij ndryshimi të veçantë ishte të heq Aneksin I apo Aneksin II të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut. Rrjedhimisht, Komisioni konsideron që të

5. Komisioni mbajti seancën e tridhjetë nga 3 deri 5 shtator 2012 në Prishtinë. Komisionit i janë paraqitur gjithsej 38 kërkesa për pronë komerciale në seancën e tridhjetë, nga Sekretaria Ekzekutive e KPA-së (“Sekretaria Ekzekutive”), së bashku me dokumentacionin mbështetës, raportet e përpunimit të kërkesave, raportet e verifikimit, memorandumet ligjore dhe informata të tjera relevante. Një kërkesë për pronë komerciale e cila i ishte referuar Komisionit, iu kthye Sekretarisë Ekzekutive nga Komisioni gjatë seancës Gjithsej 37 kërkesa për pronë banesore u vendosën nga Komisioni gjatë seancës.

6. Në seancën e Komisionit, Sekretaria Ekzekutive i ka prezantuar kërkesat Komisionit dhe ka raportuar për përpunimin e kërkesave dhe çështjet ligjore dhe dëshmuese të cilat kanë rrjedhur nga kërkesat. Më kërkesë të Komisionit, Sekretaria Ekzekutive ka ofruar informata dhe sqarime shtesë, sipas nevojës.

A. Kërkesa të përfshira në këtë vendim

7. Ky vendim zbatohet për gjashtë kërkesa nga 37 kërkesa për pronë komerciale të paraqitura Komisionit gjatë seancës së tridhjetë. Pjesa e mbetur prej 31 kërkesave trajtohen në vendimin KPCC/D/C/168/2012.

8. Në tri nga këto kërkesa të përfshira në këtë vendim, paraqitësi i kërkesës kërkon zgjidhjen e kërkesës pronësore. Në pjesën e mbetur prej tri kërkesash kërkon zgjidhjen e së drejtës së shfrytëzimit. Të gjitha këto kërkesa lidhen me prona komerciale, përfshirë sipas rastit, edhe token e bashkuar, të cilat në kohën e notifikimit janë konstatuar të shkatërruara tërësisht.

9. Komisioni vëren se kërkesat nr. 14282 dhe 53023 të referuara në pjesët A dhe B të listës së bashkangjitur janë jokontestuese në kuptimin se në kohën e notifikimit të pronave të kërkuara nuk ka pasur dëshmi të uzurpimit të paligjshëm, të shfrytëzimit apo kultivimit të këtyre pronave nga ndonjë person ose, edhe kur ka pasur dëshmi të tilla, asnjë palë nuk e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditësh të paraparë në nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedimit, në bazë të nenit 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Bazuar në informatat e ofruara nga Sekretaria Ekzekutive, Komisioni konstaton se Sekretaria Ekzekutive ka bërë përpjekje të arsyeshme për të notifikuar pronat e kërkuara, për të njoftuar personat të cilët aktualisht mund t'i kenë uzurpuar pronat, dhe persona tjerë të cilët mund të kenë interes ligjor në pronat e tilla, siç kërkohet nga neni 10.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe neni 10.1 i Ligjit nr. 03/L-079. Rrjedhimisht, këto kërkesa duhet të konsiderohen jokontestuese.

10. Komisioni vëren se kërkesat me nr. 00604, 11503, 11541 dhe 14001 të referuara në pjesën B të listës së bashkangjitur janë kontestuese në kuptimin se pala që ka uzurpuar pronën e kërkuara (“pala përgjegjëse”), e ka kontestuar vlefshmërinë e kërkesës brenda periudhës prej 30 ditëve të përcaktuar me nenin 10.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me ligjin nr. 03/L-079, ose në një fazë të mëvonshme gjatë procedurës, në pajtim me nenin 10.3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. Në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, palës përgjegjëse i është dhënë një kopje e kërkesës të paraqitur nga paraqitësi përkatës i kërkesës. Në pajtim me nenin 3.5 të Aneksit II të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, paraqitësit të kërkesës i është dhënë një kopje e përgjigjes së

kërkesës nga pala përgjegjëse. Të dy palëve, iu është dhënë kështu mundësia të komentojnë rreth informacionit të ofruar nga pala tjetër dhe çfarëdo komenti apo informacioni i tillë është marrë në konsiderate gjatë procesit të vendosjes së kërkesës.

I. Kërkesa të miratuara.

11. Me qëllim që të përmbushen kushtet e një kërkesë të vlefshme, paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, duhet të tregojë se ai ka pasur të drejtë pronësore në lidhje me pronën e kërkuar dhe se ai ose ajo nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtën pronësore për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i armatosur që ndodhi në Kosovë midis 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999.

12. Kërkesa nr. 53023 e referuar në pjesën A të listës së bashkangjitur është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e pronësisë për pronën e kërkuar (mulli) dhe riposëdimin pasi ai e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar në qershor 1999 për shkak të konfliktit të 1998-99 dhe ai nuk ka mundësi të ushtrojë të drejtat pronësore. Në mbështetje të kërkesës së tij, paraqitësi i kërkesës paraqiti lloje të ndryshme dokumentesh duke përfshirë fletën poseduese datë 22 shtator 2008, që e tregon paraqitësin e kërkesës si pronar të pronës së kërkuar. Fleta poseduese është verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si e vërtetë.

13. Komisioni, bazuar në dëshmitë para tij, konstaton se kërkesa përfshin rrethana që ndërlidhen drejtpërsëdrejti ose që rezultojnë nga konflikti i 1998-99. Po ashtu Komisioni konstaton se fleta poseduese e paraqitur nga paraqitësi i kërkesës përben një dëshmi të pronësisë për pronën e kërkuar. Komisioni konsideron se kërkesa është jokontestuese dhe asnjë dëshmi nuk është pranuar ose marrë nga Sekretaria *ex officio* e cila do të kundërshtonte supozimin e pronësisë mbi bazën e fletës poseduese. Rrjedhimisht kërkesa duhet të miratohet.

II. Kërkesa të hedhura poshtë

14. Në bazë të nenit 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni hedh poshtë të gjithë ose një pjesë të kërkesës kur:

- (a) Paraqitësi i kërkesës ka dështuar të depozitojë kërkesë në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë rregullore;
- (b) Kërkesa nuk është në fushëveprimin e juridiksionit të Agjencisë Kosovare të Pronave;
- (c) Kërkesa është shqyrtuar edhe vendosur më parë në një vendim administrativ ose gjyqësor të formë së prerë.

15. Neni 8.6 i Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut 2007/5 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-07907/50 i jep Komisionit kompetencat të refuzojë ose hedhë poshtë një kërkesë në çfarëdo baze duke përfshirë edhe ato të përcaktuara me nenin 11.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

16. Kërkesat të cilat janë hedhur poshtë për shkak se bien jashtë juridiksionit të Komisionit ose për arsye procedurale dhe jo për shkak të meritave të kërkesës, mund të vendosen nga gjykatat vendore në bazë të ligjit në fuqi. Në vendime të tilla vendimi i Komisionit nuk është *res judicata*. Neni 3.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr 03/L-079 konfirmon të drejtën e paraqitësve të kërkesave që të ndjekin kërkesat që nuk bien në mandatin e Komisionit para gjykatave me kompetencë juridiksionale ashtu si përcaktohet në nenin 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079. (Shih gjithashtu nenin 8.1 të Aneksit III të Urdhërësës Administrative të UNMIK-ut

2007/5 në lidhje me kompetencat e Komisionit për të referuar çështjet që lindin në lidhje me kërkesat të cilat nuk janë nën juridiksionin e tij një gjykatë vendore ose një bordi administrativ apo tribunalit.)

17. Sipas nenit 3.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin Nr. 03/L-079, juridiksioni i Komisionit është i kufizuar në kërkesat pronësore që ndërlidhen me konfliktin në kuptimin që përfshijnë rrethanat e ndërlidhura drejtpërsëdrejti me, apo që janë pasojë e konfliktit të armatosur që ka ndodhur në Kosovë mes 27 shkurtit 1998 dhe 20 qershorit 1999, ku paraqitësi i kërkesës tani nuk mund ta ushtrojë këtë të drejtë pronësore. Për të vërtetuar se a është kërkesa brenda juridiksionit të tij apo jo, Komisioni duhet të përcaktojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, është zhvendosur nga prona e kërkuar, ose nëse e ka humbur posedimin apo kontrollin mbi pronën e tillë, si pasojë e konfliktit. Komisioni gjithashtu duhet të vërtetojë nëse paraqitësi i kërkesës apo bartësi i së drejtës pronësore, siç mund të jetë rasti, mund të ushtrojë të drejtën e tij/saj mbi pronën e kërkuar.

18. Ndonëse Komisioni ka pikëpamjen se humbja e posedimit ka ndodhur jashtë periudhës 27 shkurt 1998 dhe 20 qershor 1999 megjithatë mund të konsiderohet se lidhet drejtpërdrejtë ose rezulton nga konflikti në varësi të rrethanave të rastit, ai duhet të konstatojë se ka dëshmi që tregon se humbja e pronës përfshin rrethana që ndërlidhen me konfliktin.

1. Kërkesa nr. 00604

19. Kërkesa nr. 00604 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore të pronës së kërkuar. Paraqitësi i kërkesës kërkon konfirmimin e së drejtës së shfrytëzimit për pronën e kërkuar (dyqan) dhe riposedimin. Në mbështetje të pretendimit të tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një numër dokumentesh të ndryshme përfshirë një vendim administrativ për planifikimin urban datë 30 prill 1996 dhe një vendim të ndarjes datë 5 maj 1997 që i miraton paraqitësit të kërkesës lejen të ndërtojë një strukturë të lëvizshme biznesi për shfrytëzim të përkohshëm në parcelën kadastrale nr. 768/3 dhe një kontratë të shfrytëzimit për pronën e kërkuar datë 29 janar 1996. Vendimi administrativ, vendimi i ndarjes dhe kontrata e shfrytëzimit janë verifikuar nga Sekretaria Ekzekutive si të vërteta. Më tej, paraqitësi i kërkesës deklaroi se e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar për qëllime komerciale në bazë të vendimit të ndarjes, pikërisht për shërbime ushqimi dhe restorant. Megjithatë, Komuna e Glogovcit e anuloi vendimin e ndarjes në vitin 2001 bazuar në një vendim të Kuvendit Komunal të Glogovcit në bazë të të cilit ishte miratuar një plan i ri urban për ndërtim. Struktura komerciale u shkatërrua në vitin 2005 kur u zbatua plani i ri urban. Vendimi i anulimit ka qenë objekt i një padie midis Komunës dhe paraqitësit të kërkesës para Gjykatës Komunale kompetente, e cila ka vendosur përfundimisht më 10 shkurt 2006 në favor të Komunës duke konfirmuar anulimin e vendimit të ndarjes dhe të drejtën për të rrënuar pronën e kërkuar.

20. Pala përgjegjëse, Komuna e Glogovcit, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, deklaroi se vendimi administrativ për të anuluar të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit të paraqitësit të kërkesës për pronën e kërkuar dhe për ta rrënuar atë, ishte i ligjshëm, pasi Komuna ka të drejtë të anulojë të drejtën e përkohshme të shfrytëzimit të çdo kohë.

21. Nuk është kontestuese midis palëve se paraqitësit të kërkesës fillimisht i është dhënë e drejta e përkohshme e shfrytëzimit për pronën e kërkuar për të ndërtuar strukturë komerciale mbi atë. Ajo që është kontestuese është fakti se a ka qenë e ligjshme anulimi i kësaj të drejte shfrytëzimi dhe rrënimi i mëpasëm i strukturës komerciale bazuar në këtë anulim. Megjithatë, Komisioni nuk ka juridiksion për të zgjidhur konteste të tilla pasi bien jashtë juridiksionit të Komisionit pasi humbja e posedimit nga paraqitësi i kërkesës nuk përfshin rrethana që

ndërlidhen drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë i vitit 1998-1999. Rrjedhimisht, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

2. *Kërkesa nr. 11503*

22. Kërkesa nr. 11503 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore për pronën e kërkuar. Paraqitësi i kërkesës pretendon se babai i tij ka qenë pronar i pronës së kërkuar deri në vitin 1959 kur prona e kërkuar është shpronësuar nga Hekurudha e Kosovës, një entitet shtetëror. Familja e paraqitësit të kërkesës nuk ka mundur të marrë riposëdimin qysh atëherë. Paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një numër dokumentesh të ndryshme duke përfshirë vendimin administrativ të shpronësimit datë 24 nëntor 1959, e cili nuk ka mundur të verifikohet nga Sekretaria Ekzekutive si i vërtetë. Me tej, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur fletën poseduese 4415 datë 13 shkurt 2002 që e tregon Hekurudhën e Kosovës si pronare të vetme të pronës së kërkuar.

23. Pala përgjegjëse pretendon se është autorizuar nga Hekurudha e Kosovës për të shfrytëzuar pronën e kërkuar. Pala përgjegjëse në mbështetje të pohimit të tij ka paraqitur një kontratë qiraje me Hekurudhën e Kosovës në lidhje me pronën e kërkuar.

24. Komisioni vëren se paraqitësi i kërkesës pretendon se babai i tij është shpronësuar në vitin 1959 dhe se ai e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar që atëherë. Nga kjo rrjedh se paraqitësi i kërkesës nuk e ka humbur posedimin e pronës së kërkuar si rezultat i rrethanave që ndërlidhen drejtpërdrejtë ose rezultojnë nga konflikti i 1998-1999. Rrjedhimisht, kërkesa bie jashtë juridiksionit të Komisionit dhe duhet të hidhet poshtë.

3. *Kërkesa nr. 11541*

25. Kërkesa nr. 11541 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të së drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ka të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar komerciale të miratuar nga Komuna e Fushë Kosovës. Megjithatë, paraqitësi i kërkesës dështoi të paraqitë dëshmi të dokumentuara në mbështetje të pretendimeve të tij duke shpjeguar se të gjitha dokumentet përkatëse, përfshirë vendimin e pretenduar të ndarjes ishin djegur gjatë konfliktit të 1998-99. Paraqitësi i kërkesës paraqiti një foto të pronës së kërkuar komerciale që tregon një barangë parafabrikat me një strukture, e cila mund të largohet.

26. Gjatë rrjedhës së notifikimit të pronës së kërkuar, është zbuluar një strukture e përhershme, pra një shtëpi dhe një garazh janë ngritur në parcelën në fjalë. Pala përgjegjëse, i cili u konstatua se kishte uzurpuar pronën e kërkuar gjatë notifikimit deklaroi se e kishte blerë shtëpinë dhe garazhin nga paraqitësi i kërkesës në vitin 2006. Në mbështetje të pohimit të tij, pala përgjegjëse paraqiti kontratën e blerjes të lidhur mes paraqitësit të kërkesës dhe palës përgjegjëse datë 16 maj 2006. Më pas, transaksioni është konfirmuar nga paraqitësi i kërkesës.

27. Komisioni vëren se kërkesa e paraqitësit të kërkesës ka të bëjë me një barangë parafabrikat. Në bazë të nenit 9 të Ligjit për të Pronësinë dhe Drejtat të tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154), prona e lëvizshme është përcaktuar si “objekte trupore të pavarura, që nuk janë në mënyrë të përhershme të lidhura me tokën ose pjesët e tokës dhe që në përgjithësi mund të lëvizin”. Prona e kërkuar është në këtë përkufizim dhe për rrjedhojë duhet të konsiderohet pronë e lëvizshme. Statusi i tanishëm i pronës së kërkuar nuk ndikon në konstatimet e Komisionit pasi paraqitësi i kërkesës nuk ka bërë kërkesë për shtëpinë dhe garazhin që tani ndodhen në pronën e kërkuar dhe në të vërtetë paraqitësi i kërkesës ka pranuar se këto janë shitur me anë të transaksionit vullnetar. Rrjedhimisht, pasi Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat që lidhen me pronën e luajtshme, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

4. Kërkesa nr. 14001

28. Kërkesa nr. 14001 është depozituar nga përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të kërkesës. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ka të drejtën pronësore për lokalitetin e kërkuar komerciale për të cilin pretendon se e ka humbur posedimin gjatë konfliktit të 1998-99. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një numër dokumentesh të ndryshme përfshirë vendimin e ndarjes nga Komuna e Pejës datë 5 qershor 1992 që i miraton paraqitësit të kërkesës të drejtën e përkohshme për shfrytëzimin e tokës komunale dhe lejen për të ngritur një strukturë për qëllime komerciale në tokë. Vendimi i ndarjes është verifikuar si i vërtetë nga Sekretaria Ekzekutive.

29. Pala përgjegjëse pretendon se e ka blerë pronën e kërkuar nga një palë e tretë në vitet 1970 dhe se e ka shfrytëzuar pronën e kërkuar nga viti 1978 derisa ajo pretendohet të jetë shkatërruar në mënyrë të paligjshme në vitin 1990 mbi bazën e urdhrit të Komunës së Pejës. Pala përgjegjëse pretendon se më vonë ai e rindërtoi pronën.

30. Sekretaria Ekzekutive ka siguruar *ex officio* fletën poseduese nr. 2608 e cila e tregon Kuvendin Komunal të Pejës si pronar të pronës së kërkuar.

31. Komisioni vëren se në bazë të vendimit të ndarjes të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës, paraqitësit të kërkesës i është miratuar e drejta e përkohshme e shfrytëzimit për token si edhe leja për ndërtimin e një strukture të përkohshme mbi atë. Në bazë të nenit 9 të Ligjit për të Pronësinë dhe Drejtat te tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154), prona e lëvizshme është përcaktuar si “objekte trupore të pavarura, që nuk janë në mënyrë të përhershme të lidhura me tokën ose pjesët e tokës dhe që në përgjithësi mund të lëvizin”. Prona e kërkuar është në këtë përkufizim dhe për rrjedhojë duhet të konsiderohet pronë e lëvizshme. Statusi i tanishëm i pronës së kërkuar nuk ndikon në konstatimet e Komisionit pasi paraqitësi i kërkesës nuk ka bërë kërkesë për strukturat ekzistuese që ndodhen në tokë. Rrjedhimisht, pasi Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat që lidhen me pronën e luajtshme, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

5. Kërkesa nr. 14282

32. Kërkesa nr. 14282 është depozituar nga paraqitësi i kërkesës në cilësinë e mbajtësit të se drejtës pronësore. Paraqitësi i kërkesës pretendon se ka të drejtën e shfrytëzimit për pronën e kërkuar komerciale, pikërisht një dyqan. Në mbështetje të kërkesës, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur një numër dokumentesh të ndryshme përfshirë vendimin e ndarjes datë 21 nëntor 1997 të lëshuar nga Gjykata Komunale e Klinës në bazë të të cilit paraqitësit të kërkesës i është miratuar leja për të ndërtuar një strukturë të përkohshme në token komunale.

33. Gjatë notifikimit të pronës së kërkuar nga Sekretaria Ekzekutive, u zbulua se nuk ekzistonte strukturë komerciale e përkohshme në pronën e kërkuar e cila tani shfrytëzohet si vendparkim.

34. Komisioni vëren se në bazë të vendimit të ndarjes të paraqitur nga paraqitësi i kërkesës, paraqitësit të kërkesës i është miratuar e drejta e përkohshme e shfrytëzimit për token si edhe leja për ndërtimin e një strukture të përkohshme mbi atë. Në bazë të nenit 9 të Ligjit për të Pronësinë dhe Drejtat te tjera Sendore (Ligji nr. 03/L-154), prona e lëvizshme është përcaktuar si “objekte trupore të pavarura, që nuk janë në mënyrë të përhershme të lidhura me tokën ose pjesët e tokës dhe që në përgjithësi mund të lëvizin”. Prona e kërkuar është në këtë përkufizim dhe për rrjedhojë duhet të konsiderohet pronë e lëvizshme. Statusi i tanishëm i pronës së kërkuar nuk ndikon në konstatimet e Komisionit pasi e drejta e

shfrytëzimit për paraqitësin e kërkesës ka qenë e përkohshme dhe duhet te konsiderohet se ka skaduar. Rrjedhimisht, pasi Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesat që lidhen me pronën e luajtshme, kërkesa duhet të hidhet poshtë.

B. Kërkesa kompensimi

35. Në kërkesat nr. 11541 dhe 14282 paraqitësi i kërkesës, kërkon gjithashtu përveç pronësisë, kompensimin për demin fizik ose për humbjen e shfrytëzimit për pronën e kërkuar. Sipas Rregullores së UNMIK/REG-ut 2006/50 e miratuar me Ligjin nr. 03/L-079, Komisioni nuk ka juridiksion për kërkesa të tilla. Për rrjedhojë këto kërkesa për kompensim duhet të hidhen poshtë.

C. Vërejtje përmbledhëse

36. Vendimi dhe urdhri i mësipërm i Komisionit gjithashtu aplikohen, ku është e përshtatshme, edhe për çdo pronë të bashkuar, d.m.th. për çdo tokë apo ndërtesë të zotëruar apo të shfrytëzuar nga paraqitësi i kërkesës ose bartësi i së drejtës pronësore, sipas rastit, të cilat formojnë një njësi me pronën e kërkuar.

37. Neni 8.8 i Aneksit III të Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut nr. 2007/5 të miratuar me Ligjin 03/L-079 lejon Kryetarin e Komisionit të nënshkruajë vendimin grupor duke aprovuar të gjitha kërkesat individuale të identifikuara në vendimin grupor, nëse numri i kërkesave të vendosura gjatë seancës është i lartë. Komisioni konsideron se kjo aplikohet në rastin konkret.



Kryetari

ANKESAT

Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50 dhe Ligji Nr. 03/L-079 parashohin që:

12.1 Brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi kërkesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës.

12.3 Ankesa mund të paraqitet duke u bazuar në atë se:

- (a) Vendimi përmban gabim thelbësor apo moszbatim serioz të ligjit material apo procedural; apo
- (b) Vendimi mbështetet në vlerësim të gabuar apo të mangët të fakteve.

Gjykata Supreme e Kosovës mund të vjelë tarifën e gjyqësore për procedurën e ankesës.

Informacione lidhur me procedurën e ankesave gjenden në fletën informuese për ankesën e cila u ofrohet palëve së bashku me vendimin.

*** Versioni në gjuhën angleze është versioni zyrtar i të gjitha vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore. Në rast të mospërputhjes mes versionit në gjuhën angleze dhe versionit në gjuhën shqipe apo serbe, atëherë mbizotëron versioni në gjuhën angleze**

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part A/Pjesa A/Deo A

KPA53023						
----------	--	--	--	--	--	--

Spreadsheet /Lista /Prilog
Part B/Pjesa B/Deo B

KPA00604
KPA11503
KPA14001
KPA11541
KPA14282